



Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren
University "Ukshin Hoti" Prizren

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Universitet Prizren "UKSHIN HOTI"	
Pranuar më datë: 11.05.2022	
Zyra e pranimit	Nr. i protokollit
308	01-197

KËSHILLI DREJTUES

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren - Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Kryesues i Këshillit Drejtues
Prof. Asoc. Dr. Arif Murrja

Prizren, më 11.05.2022

Në mbështetje të nenit 17, paragrafi 1 dhe 3 dhe nenit 23, paragrafi 1.3 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, Këshilli Drejtues i Universitetit të Prizrenit, në mbledhjen e mbajtur më 28.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Rregullorja mbi përcaktimin e kriterëve për ndarjen e Bursave, Shpërblimeve dhe Formave tjera të mbështetjes financiare për studentët e Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi do të jetë edhe Rregullorja e sipërsënuar.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prof. Asoc. Dr. Arif Murrja

Kryesues i Këshillit Drejtues

Vendimi i dërgohet:

- Këshillit Drejtues;
- Menxhmentit;
- Sekretarit të Përgjithshëm;
- Zyrës Ligjore;
- Arkivit.



11.05.2022

308

01-197/A



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000
Prizren, Republika e Kosovës
www.uni-prizren.com

RREGULLORE

**MBI PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR NDARJEN E BURSAVE, SHPËRBLIMEVE
DHE FORMAVE TË TJERA TË MBËSHETJES FINANCIARE PËR STUDENTËT E
UNIVERSITETIT "UKSHIN HOTI" NË PRIZREN**



Në mbështetje të nenit 17 paragrafi 1 dhe 3 dhe nenit 23 paragrafi 1.3 të Statutit të Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti", Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur, me datë 28.03.2022, miraton:

RREGULLORE MBI PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR NDARJEN E BURSAVE, SHPËRBLIMEVE DHE FORMAVE TË TJERA TË MBËSHTETJES FINANCIARE PËR STUDENTËT E UNIVERSITETIT "UKSHIN HOTI" NË PRIZREN

Neni 1

Fushëveprimtaria

Kjo rregullore ka për qëllim rregullimin e procesit të ndarjes së bursave për studentë. Bursë për studentë konsiderohet shuma financiare e ndarë nga Universiteti për studentët e nivelit Baçelor dhe Master gjatë një viti akademik që plotësojnë kriteret e paracaktuara me këtë rregullore.

Neni 2

Bursa studentore

Universiteti, me anë të konkursit, përcakton kushtet për aplikim për bursë studentore për nivelin e studimeve. Bursë studentore është shuma financiare të cilën e përfitojnë studentët që plotësojnë kriteret e paracaktuara me këtë rregullore.

Neni 3

Buxheti dhe lartësia e bursës

Lartësia e shumës financiare të bursës përcaktohet nga kriteret e mëposhtme:

- 3.1. Nga numri i studentëve që përmbushin kushtet për përfitimin e bursës;
- 3.2. Nga buxheti i ndarë nga Universiteti për këtë destinim;
- 3.3. Lartësia e bursës universitare do të përcaktohet nga Këshilli Drejtues i Universitetit për çdo vit akademik, me një vendim të veçantë, varësisht nga buxheti dhe numri i studentëve që i plotësojnë kushtet.

Neni 4

Student i dalluar

- 4.1 Universiteti ndan çmimin "Student i dalluar". Ky çmim u takon studentëve të vitit të fundit të studimeve (baçelor dhe master) me notë mesatare 10.00.
- 4.2 Në mungesë të tyre, çmimi "Student i dalluar", mund t'u ndahet edhe studentëve të vitit të fundit të studimeve me notë mesatare jo më pak se 9.5 (nga dy studentë për çdo njësi akademike).
- 4.3 Për këtë çmim mund të konkurrojnë studentët me propozim të Parlamentit Studentor dhe miratim të Këshillit të Fakultetit



4.4 Lartësinë e çmimit “Student i dalluar” e përcakton Këshilli Drejtues, me vendim të veçantë.

4.5 Dëshmia për “Studentin e dalluar” dorëzohet pas përfundimit të afatit të shtatorit të vitit pasues.

Neni 5

Bursa për persona me aftësi të kufizuara

5.1 Universiteti mbështet kategoritë të cilat janë me nevoja të veçanta, këto kategori janë të përcaktuara me ligjet e Republikës së Kosovës.

5.2 Ndarjen e bursave për këtë kategori e përcakton Këshilli Drejtues me vendim të posaçëm

Neni 6

Kriteret për përfitimin e bursave

Kushtet për aplikim për bursë studentore janë:

6.1 Të jetë student i rregullt i Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren;

6.2 Të jetë student i vitit të dytë e më lart;

6.3 Të mos ketë vit të përsëritur të studimeve;

6.4 Të ketë dhënë të gjitha provimet e vitit paraprak përkatës të studimeve deri në afatin e shtatorit;

6.5 Të ketë notë mesatare të studimeve më së paku:

6.5.1 Tetë pikë pesë (8.5) – për studentët e nivelit të studimeve Baçelor në Fakultetin e Shkencave të Jetës dhe Mjedisit dhe Fakultetin e Shkencave Kompjuterike;

6.5.2 Nëntë pikë zero (9.00) – për studentët nivelit të studimeve Baçelor të Fakultetit Juridik, Ekonomik, Filologjisë dhe të Edukimit;

6.5.3 Tetë pikë pesë (8.5) – për studentët e nivelit të studimeve Master në Fakultetin e Shkencave të Jetës dhe Mjedisit dhe Fakultetin e Shkencave Kompjuterike;

6.5.4 Nëntë pikë zero (9.00) – për studentët e nivelit të studimeve Master të Fakultetit Juridik, Ekonomik, Filologjisë dhe të Edukimit.

Neni 7

Pengesat dhe ndalesat për dhënien e bursës studentore

Studentët të cilët plotësojnë kriteret nga Neni 4, por nuk mund të marrin bursë nga Universiteti janë:

7.1 Studentët ndaj të cilëve komisionet disiplinore kanë shqiptuar masa disiplinore gjatë studimeve në Universitetin “Ukshin Hoti” të Prizrenit;

7.2 Studentët që janë të dënuar nga gjykata me aktgjykim të plotfuqishëm dhe të ekzekutueshëm për vepër penale gjatë kohës së studimeve;



- 7.3 Pjesë e aplikimit do të jetë edhe deklarata nën betim nga studenti se ai nuk ka ndalesa për ndarjen e bursës siç parashihet në dy nënparagrafët e mësipërm;
- 7.4 Zyra Ligjore në kuadër të Rektoratit përgatit formularin e deklaratës nga paragrafi 2 i këtij neni.
- 7.5 Deklarata plotësohet dhe nënshkruhet nga secili student që aplikon për bursë.

Neni 8

Afatet procedurale

Afatet kohore për fillimin dhe përfundimin e procedurave të konkursit të bursave të studentëve:

- 8.1 Afati për aplikim për bursa të studentëve duhet të jetë së paku 7 (shtatë) ditë, e më së shumti 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e shpalljes së konkursit.¹
- 8.2 Afati për shqyrtim të aplikimeve dhe shpallje të përfutësve duhet të jetë jo më shumë se 5 (pesë) ditë pune.
- 8.3 Afati për ankesa nga studentët pas shpalljes së rezultateve është 2 (dy) ditë pune.
- 8.4 Afati për shqyrtim të ankesave nga komisioni për ankesa është 2 (dy) ditë pune.

Neni 9

Komisioni për ndarjen e bursave

Vlerësimin e aplikimeve për bursa të studentëve e bën komisioni i emëruar nga Këshilli Drejtues i Universitetit. Ky komision në përbërje duhet të ketë 3 (tre) anëtarë:

- 9.1 Një përfaqësues i Këshillit Drejtues
- 9.2 Një përfaqësues i Zyrës Ligjore
- 9.3 Parlamenti Studentor mund të dërgojë 1 (një) përfaqësues, i cili nuk është pjesë e konkursit.
- 9.4 Komisioni mban përgjegjësi ligjore për punën e tij.

Neni 10

Komisioni për ankesa

Këshilli Drejtues njëkohësisht emëron Komisionin dhe kryesuesin e komisionit për ankesa, i cili në përbërje ka 3 (tre) anëtarë:

- 10.1 Një anëtar i Këshillit Drejtues
- 10.2 Prorektori për buxhet dhe financa
- 10.3 Sekretari i Universitetit
- 10.4 Parlamenti Studentor mund të dërgojë një (1) përfaqësues (student) si vëzhgues (pa të drejtë vote), i cili nuk është pjesë e konkursit

¹ Kohëzgjatja e konkursit përcaktohet me vendim të Këshillit Drejtues çdo vit akademik, varësisht nga dinamika e proceseve akademike



10.5 Komisioni vepron në bazë të ankesave të palëve dhe vendimet i merr në pajtueshmëri me Ligjin për Procedurën Administrative, Statutin e Universitetit, këtë Rregullore dhe konkursin për bursa.

10.6 Komisioni mban përgjegjësi ligjore për punën e tij.

Neni 11

Shpallja e konkursit


Shpallja e konkursit për bursa duhet të bëhet në afat kohor jo më shumë se 60 ditë pas mbylljes së afatit për regjistrim të semestrit dimëror.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kryesuesi i Këshillit Drejtues


Prof. Asoc. Dr. Arif Hoti

